UDHËZIM
Nr. 3, datë 15.5.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 19.5.2015 "PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR LISTIMIN DHE HEQJEN NGA LISTA E ADMINISTRATORËVE TË NDËRTESAVE, PENALITETET DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË SË TYRE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 22 pika 1, paragrafi i dytë dhe të nenit 46, pika 2, të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", Ministri i Zhvillimit Urban

UDHËZON:

1. Në Kreun II, neni 4, germa "d", shfuqizohet.
2. Në nenin 4, pika 2, pas germës "b", shtohet germa "c", me përmbajtje si vijon:

"c. Vërtetojnë nëpërmjet ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit se nuk kanë statusin "të pezulluar" ose "në procedurë falimenti".

3. Në nenin 5, pika 2, germa "c", ndryshohet si më poshtë:

"c. Ekstrakt për personat juridik lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për QKR;"

4. Neni 17, riformulohet si më poshtë:

"Neni 17

1. Deri më 1 mars 2018, personat fizikë dhe juridikë regjistrohen në librin e administruesve, pa plotësuar kushtin e kryerjes së kursit të formimit profesional për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, pasi të kenë plotësuar kushtet dhe kriteret e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Brenda kësaj periudhe, personat fizikë dhe individët e punësuar nga personat juridikë, përgjegjës për administrimin e bashkëpronësisë, duhet të pajisen me certifikatën e kryerjes së kursit profesional. Pas afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, këta persona duhet të aplikojnë për konfirmimin e regjistrimit në librin e administruesve, sipas nenit 4 të këtij udhëzimi. Në mungesë, administratorët do të hiqen automatikisht nga libri i administruesve.".

5. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni